



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 432/9 Prot.

Tiranë, më 26._07.2023

V E N D I M

Nr. 141, datë 26 .07. 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”², të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 46 Regj, datë 24.03.2023, paraqitur nga znj. E.Q (në vijim ankuesja), kundër z. B.M, Mjek Familje pranë Qendrës Shëndetësore nr.9, Tiranë (Poliklinika Nr.9, Tiranë), në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “moshës”, “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese E.Q parashtron se është e moshuar, 79 vjeçe, jeton e vetme, pa fëmijë, dhe e sëmurë nga mosha. Ankuesja shpjegon se, ka gati 3 vite që i kërkon mjekut të familjes B.M të kalojë kartelën origjinale mjekut tjetër ku dëshiron të transferojë kartelën e saj mjekësore, sepse është e pakënaqur dhe ndihem e diskriminuar nga ky mjek. Ankuesja pretendon se, mjeku i familjes B.M nuk e ka pritur mirë dhe i ka mbyllur derën kur ajo ka shkuar të marrë shërbime mjekësore dhe se i ka mohuar të drejtën për të kaluar tek mjeku tjetër N.Gj Mjeku i familjes, z. B.M është mjaftuar duke bërë një fotokopje të kartelës dhe ia ka dhënë për t’u paraqitur tek mjeku tjetër. Ankuesja pretendon se, pasi ka shkuar tek mjeku tjetër i familjes ku ajo dëshiron të transferohet, ky i fundit i ka thënë se, me fotokopje nuk bëhet dot gjë pasi duhet kartela origjinale.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

² Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

Ankuesja kërkon nga Komisioneri që të zgjidhet kjo situatë, pasi është e sëmurë, ka nevojë të vizitohet dhe nuk merr dot rekomandim për të vijuar vizitat, pasi kartela origjinale vazhdon të jetë tek mjeku B.M, dhe se ai nuk e aprovon që ankuesja kërkon të kalojë në mjek tjetër. Ankuesja pretendon gjithashtu se mjeku i familjes z. B.M, e ka diskriminuar dhe nuk respekton të drejtat e saj si paciente, e sëmurë, e moshuar, duke i shtyrë derën dhe duke mos e pranuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, ankuesja kërkon nga Komisioneri marrjen e masave për kalimin e kartelës origjinale tek mjeku tjetër i familjes ku ankuesja ka kërkuar të kalojë, në mënyrë që të mund të kryejë vizitat për të cilat ka nevojë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “a”, të LMD, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh, duke përcaktuar në nenin 1, të tij se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD, të ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

Ankesa e pararitur ishte në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të LMD, e ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1.1 Me shkresën me nr.432/1 prot., datë 29.03.2023, Komisioneri ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga z. B.M, Mjek Familje pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë dhe nga Qendra Shëndetësore Nr.9, Tiranë, në lidhje me pretendimet e parashtruara nga pala ankuese. Në përgjigje të kësaj kërkesë për informacion, z. B.M, ktheu përgjigje në lidhje me pretendimet e paraqitura nga ankuesja, duke informuar ndër të tjera se:

Znj. E.Q ka kërkuar verbalisht të tërheqë kartelën personale mjekësore dhe sipas udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi ka marrë sqarime nga ana e tij si mjek familje, duke i treguar mënyrën se si duhet të vepronte për realizimin e kësaj kërkesë të bërë vetëm verbalisht prej saj.

Pretendimi i znj. Q se ajo është diskriminuar dhe nuk është pritur mirë nga ana e tij, është i pabazuar, pasi po të hedhësh vështrimin në kartelën e saj mjekësore duket qartë që ajo ka marrë shërbime të herëpashershme shëndetësore, përfshirë dhe ekzaminime të ndryshme sipas rasteve. I pabazuar është edhe pretendimi i znj. Q se nuk merr dot rekomandime për vijimin e kontrollit mjekësor, pasi është penguar aprovimi nga ana e tij si mjek i familjes, pasi znj. E.Q e ka një mjek tjetër familje dhe konkretisht Dr.N.Gj.

Z. B.M, informon se, aktualisht znj. E.Q, trajtohet me mjekun e familjes Dr.N.Gj, sipas një kërkesë të ardhur elektronikisht nga vetë mjeku i mësipërm në shkurt 2023 dhe është konfirmuar nga ana e z. M elektronikisht në fillim të muajit mars 2023. Në datën 08.03.2023, z. M, informon se, ka dorëzuar personalisht në zyrën e mjekut përkatës dokumentacionin e kartelës personale mjekësore të znj. E.Q. Znj.Q nuk ka paraqitur ndonjë arsye për ndryshimin e mjekut dhe në dijeninë e tij, ajo nuk ka paraqitur ndonjë ankesë pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë.

1.2 Në datën 20.04.2023, ankuesja paraqiti kundërshtimet e saj (protokolluar me nr.432/3 prot.) në lidhje me shkresën e sipërcituar, duke parashtruar:

Përgjigja e dërguar nga Dr.B.M është një mashtrim që vazhdon t'i bëhet ankueses si një plakë e vetme, e sëmurë dhe pa mbrojtje. Znj. Q shprehet se ka kërkuar verbalisht tërheqjen e kartelës së shëndetit por edhe nëpërmjet aplikimit në sistem, për të transferuar kartelën e shëndetit që doktori B.M e mban akoma me pa të drejtë, për të kaluar tek doktori tjetër. Ajo thekson se, nuk është pritur asnjë herë nga ky doktor. Ankuesja pretendon se në kartelën e saj mjekësore janë bërë ndërhyrje dhe fallsifikime, dhe se është kjo arsyeja që doktori nuk e jep kartelën e saj origjinale. Sipas ankueses, kur i ka kërkuar doktorit rekomandime, ai ka shënuar se ka probleme të shëndetit mendor, kur nuk i takon këtij mjeku që të shkruajë në rekomandim se ajo ka probleme mendore, pasi për të vërtetuar këto sëmundje janë të tjerë mjekë dhe krijohet një komision në Spitalin Nr.5, Tiranë.

2. Nëpërmjet shkresës nr.432/4 prot datë 24.04.2023, Komisioneri kërkoi informacion shtesë nga z. B.M, në lidhje me procedurën e ndjekur për kalimin ankueses pranë mjekut tjetër të familjes dhe shërbimet mjekësore dhe ekzaminimet që ankuesja ka marrë nga viti 2020 e në vijim.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, z. B.M, depozitoi pranë Komisionerit parashtrimet e tij me shkrim të cilat u administruan me nr.432/4 prot, datë 09.05.2023, duke informuar ndër të tjera se:

Mjeku nuk ka akses në regjistrin elektronik deri në nivelin e kërkuar të informacionit dhe për të marrë informacionin e kërkuar ai ka paraqitur kërkesën e bërë në datën 28.04.2023 pranë strukturave përgjegjëse, nga të cilat ka marrë përgjigje në datën 03.05.2023.

Z. M, deklaroi se, shërbimet shëndetësore dhe ekzaminimet e ndryshme mjekësore që ka marrë znj. E.Q janë të pasqyruara në kartelën e saj personale mjekësore e cila tashmë është pranë mjekut të familjes Dr. N.Gj. Gjithashtu, z.M, thekson se, si mjek familje ai ka të kartelizuar rreth 468 pacientë mbi 70 vjeç, të sëmurë kronikë me mbi 1000 diagnoza kronike si dhe shumë pacientë të tjerë, dhe për të gjitha këto kategori nuk ka patur asnjëherë ankesa për diskriminim.

3. Me shkresën nr.432/3 prot datë 24.04.2023, Komisioneri iu drejtua me një kërkesë të përsëritur për informacion Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë, e cila nuk kishte kthyer asnjë përgjigje për shkresën nr.432/1 prot., datë 29.03.2023, të Komisionerit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Qendra Shëndetësore Nr.9, Tiranë, ktheu përgjigje nëpërmjet shkresës nr. 169 prot., datë 08.05.2023, duke informuar se:

Znj. E.Q ka kërkuar verbalisht të tërheqi kartelën personale mjekësore nga mjeku B.M. Sipas udhëzimeve dhe legjislacionit në fuqi nga ana e Dr. B.M, i janë dhënë sqarime dhe i është treguar mënyra se si duhet të vepronte për realizimin e kësaj kërkesë. Në vijim, kërkesa e znj. Q për ndryshimin e mjekut të familjes është realizuar, pasi ajo është kartelizuar pranë një mjeku tjetër të familjes, përkasisht Dr.N.Gj. Znj. E.Q aktualisht trajtohet me mjekun e familjes Dr.N.Gj, bazuar në një kërkesë të ardhur elektronikisht nga ky mjek në fund të muajit shkurt 2023 dhe është konfirmuar nga ana e Dr. B.M elektronikisht në fillim të muajit mars 2023. Në datën 08.03.2023, kartela personale mjekësore është dorëzuar në zyrën e mjekut përkatës. Znj. E.Q nuk ka paraqitur asnjë arsye për ndryshimin e mjekut të familjes dhe nuk ka paraqitur asnjë ankesë pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë.

4. Me shkresën nr.432/7 prot datë 23.05.2023, Komisioneri kërkoi nga Qendra Shëndetësore Nr.9, Tiranë, informacion në lidhje me shërbimet mjekësore dhe ekzaminimet që ka marrë ankuesja nga viti 2020 e në vazhdim, si dhe në lidhje me kalimin e kartelës origjinale të ankueses pranë mjekut të familjes. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr.203 prot daë 26.05.2023, Qendra Shëndetësore Nr.9, Tiranë vuri në dispozicion kopje të njehsuar të epikrizës së përmbledhur të vizitave dhe ekzaminimeve të kryera pranë Mjekut të Familjes Dr. B.M dhe se ky i fundit ka informuar se, i ka vënë në dispozicion znj. E.Q kopjen e kartelës mjekësore, pasi kartelën origjinale e disponon vetë doktori në kartotekë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Bazuar në provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja E.Q, e datëlindjes 04.12.1944, është banore në qytetin e Tiranës. znj. E.Q ka marrë shërbime shëndetësore në Qendrën Shëndetësore Nr.9, Tiranë pranë Mjekut të Familjes z. B.M. Aktualisht ajo figuron e regjistruar pranë Qendrës Shëndetësore Nr.5, Tiranë dhe ka si Mjek Familje Dr. N.Gj.

Ankuesja pretendon se, Mjeku i Familjes Dr. B.M, nuk e ka pritur mirë dhe i ka mbyllur derën kur ajo ka shkuar të marrë shërbime mjekësore dhe se me veprimet dhe mosveprimet e tij, i ka mohuar të drejtën për të kaluar tek mjeku tjetër i familjes i zgjedhur prej saj. Mjeku B.M sipas ankueses, nuk ka aprovuar kërkuesën e saj për të kaluar tek mjeku tjetër i zgjedhur prej saj dhe nuk ka dorëzuar kartelën mjekësore origjinale të ankueses. Kjo sjellje nga ana e mjekut B.M, sipas ankueses e ka penguar që të marrë rekomandime për të vijuar me vizitat, pasi ajo është e moshuar dhe e sëmurë.

Në këto kushte, ankuesja E.Q ka paraqitur pranë Komisionerit ankesën nr. 46 regj., datë 24.03.2023, në të cilën pretendon se është diskriminuar nga z. B.M, Mjek Familje pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë, për shkak të “moshës”, “gjendjes shëndetësore” dhe “çdo shkak tjetër”³.

Në bazë të nenit 3, pika 1 të LMD, diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Në Kreun IV, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD, në nenin 20, pika 1, përcakton se: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.” Me specifikisht në pikën 2, germa “b”, të nenit 20, të LMD, parashikohet se : “2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:... b) mundësi për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin; ”

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesja është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- ankuesja është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke dalluar, përjashtuar apo kufizuar ankuesen për të marrë ose për të përfituar nga të mirat apo shërbimet që kanë të bëjnë me shëndetin;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;

³ Pa përcaktuar, shpjeguar apo dokumentuar se çfarë pretendon a justifikon ankuesja me këtë shkak.

- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një ose më shumë, nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga LMD.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesja, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ajo i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, nga ana e z. B.M, Mjek Familje pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë.

Bazuar në informacionin dhe aktet e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se:

Me datë 27.02.2023, është kryer aplikimi në sistem për tërheqje të znj. E.Q, nga ana e Dr. N.Gj, mjek pranë Qendrës Shëndetësore Nr.5, Tiranë, ndërsa më datë 28.02.2023, është kryer konfirmimi në sistem nga ana e mjekut B.M, Qendra Shëndetësore Nr.9, Tiranë. Pra, rezulton e provuar se, që prej datës 28.02.2023, kur mjeku B.M ka kryer konfirmimin në sistem, znj. E.Q figuron e regjistruar në sistem pranë Mjekut të Familjes Dr. N.Gj, Qendra Shëndetësore Nr.5, Tiranë.

Rezulton se, procedura dhe mënyra që duhet të ndiqet nga personat për ndryshimin e mjekut të familjes, rregullohet sipas Udhëzimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor Nr. 13, datë 10.02.2020 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e Fondit Nr.3, datë 10.02.2017 “Për regjistrimin elektronik të banorëve pranë mjekut të familjes”. Nr.3, datë 10.02.2018”. Në këtë Udhëzim, përcaktohet:

“ A. Në Kapitulli I “Dispozita të përgjithshme”, Pika 3 riformulohet si më poshtë:

3. Çdo person ka të drejtë të zgjedhë vetëm një mjek, si dhe të ndryshojë Mjekun e Përgjithshëm dhe të Familjes brenda mjekëve të Qendrave Shëndetësore në fushën e mbulimit të Drejtorisë Rajonale/degës së Fondit ku personi ka banimin e përhershëm në Republikën e Shqipërisë, sipas Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile.

C. Pas Kapitullit III “procedura për ndryshimin/largimin nga mjeku të banorëve”, shtohet Kapitulli III/I “procedura për ndryshimin/largimin nga mjeku të banorëve nëpërmjet Portalit e-Albania” me përmbajtje:

Për të ndryshuar mjekun e familjes nëpërmjet Portalit e-Albania ndiqen etapat e mëposhtme:

1. Banori identifikohet si qytetar në portalin e-Albania dhe zgjedh shërbimin “regjistrim/Ndryshim i individit pranë Mjekut të Familjes”;
2. Qytetari më pas përzgjedh Qendrën Shëndetësore dhe mjekun pranë të cilit kërkon të transferohet;
3. Kërkesa dërgohet për shqyrtim tek mjeku i familjes ekzistues dhe tek mjeku që është përzgjedhur për transferim;
4. Mjeku që është përzgjedhur për transferim vihet në dijeni mbi vendbanimin e banorit nëpërmjet një mesazhi në telefon;

5. Qytetari njoftohet me mesazh në telefon, me e-mail dhe tek “Mesazhet e mia” në rubrikën “hapësira ime” në portalin e-Albania për miratimin apo refuzimin e kërkesës;
6. Në rastet kur kërkesa për ndryshim të mjekut të familjes refuzohet nga mjeku i përzgjedhur, qytetari njihet mbi këtë refuzim, dhe njoftohet që mund të kryejë sërish aplikimin për t’u transferuar pranë një mjeku tjetër familje;
7. Në rast të pranimit të kërkesës nga mjeku i përzgjedhur për t’u transferuar, mjeku i familjes nga i cili do të largohet banori, do të kryejë në sistemin online konfirmimin e kërkesës së ardhur nga mjeku ku do të shkojë rekordi i banorit. Në rast mosmarrëveshje mes mjekëve për këtë procedurë, njoftohen Drejtorët e Qendrave Shëndetësore përkatëse dhe Drejtoria Rajonale e Fondit, të cilët do të monitorojnë procesin për ndjekjen e rastit dhe marrjen e masave për zgjidhjen e tij.
8. Pas konfirmimit të statusit “Larguar” të bërë nga mjeku nga i cili largohet banori, kryhet transferimi në sistem i banorit. Në këtë moment, Qendra Shëndetësore nga e cila largohet personi, brenda një jave bën dërgimin e kartelës së kërkuar në rrugë postare në destinacionin e ri.”

Nga të dhënat e administruara nuk rezulton që ankuesja të ketë bërë kërkesë tjetër përveç aplikimit të bërë në sistemin elektronik në datën 27.02.2023 nga Mjeku i familjes Dr. N.Gj. Rezulton se, kërkesa për ndryshimin e mjekut të familjes është miratuar nga mjeku B.M në datën 28.02.2023, pra vetëm një ditë pas paraqitjes së kërkesës për kalimin e ankueses pranë mjekut tjetër të familjes. Sa më sipër, bazuar në rregullimin që bën udhëzimi i sipërcituar, nuk konstatohen veprime ose mosveprime nga ana e Mjekut të Familjes Dr. B.M, të cilat kanë penguar ankuesen për të ndryshuar mjekun e familjes.

Në lidhje me pretendimet e ankueses, se nuk është pritur mirë apo që Mjeku i Familjes Dr. B.M i ka mbyllur derën kur ajo ka shkuar të marrë shërbime mjekësore, gjatë shqyrtimit të ankesës nuk u administrua asnjë provë apo indicie, për të provuar pretendimet e ankueses. Rrjedhimisht pretendimet e ankueses mbeten vetëm të nivelit deklarativ dhe në nivel pretendimesh, pasi nuk rezultuan të provuara. Gjatë kohës që ankuesja ka marrë shërbime mjekësore pranë Dr. B.M, Mjek Familje pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9 Tiranë, nuk rezulton që ankuesja të ketë paraqitur ndonjë ankesë kundër tij.

Ankuesja pretendon se, Mjeku i familjes Dr. B.M, duke mos dorëzuar kartelën personale mjekësore origjinale, e ka penguar atë që të marrë rekomandimet përkatëse për të vijuar vizitat, për të cilat ka nevojë pasi është e moshuar dhe e sëmurë. Në lidhje me këtë pretendim të ankueses, Qendra Shëndetësore Nr.9, Tiranë, informoi se, Dr. B.M, ka vënë në dispozicion kopjen e kartelës personale mjekësore, ndërsa kartela origjinale disponohet nga doktori në kartotekë. Referuar kopjes së njehsuar të epikrizës së përmbledhur të vizitave dhe ekzaminimeve të kryera nga ankuesja pranë Mjekut të Familjes Dr. B.M, të vendosur në dispozicion nga Qendra Shëndetësore nr.9, Tiranë, rezulton se, nga viti 2020 e deri në fillim të vitit 2022, ankuesja ka bërë disa vizita, ka marrë rekomandime, ka kryer analiza dhe ekzaminime, si dhe ka marrë mjekimet përkatëse.

Ankuesja pretendon se, kur ajo ka kërkuar rekomandime, Mjeku i Familjes Dr. B.M, ka shënuar se ajo ka probleme me shëndetin mendor, ndërsa nuk i takon këtij mjeku që të shkruajë në rekomandim se ajo ka probleme të shëndetit mendor, pasi për të vërtetuar këto sëmundje janë mjekë të tjerë dhe krijohet komision në Spitalin Nr.5, Tiranë.

Në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Qendra Shëndetësore Nr.9, Tiranë, rezulton se, në tre raste në epikrizën e përmbledhur të ankuseses pasqyrohet si vijon: “*Datë 17.11.2020 (për dy muaj) - Vizitë tek Psikiatri*”; “*Datë 09.04.2021 – Vizitë Psikiatri*”; “*Datë 04.04.2022 – Konsultë Psikiatri*”.

Vendimi nr.101, datë 4.2.2015 i Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e paketës së shërbimeve shëndetësore, në kujdesin shëndetësor parësor publik, që financohet nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor*”, të ndryshuar, parashikon ndër të tjera, dy kategori shërbimesh: “Kujdesi shëndetësor për të moshuarit (mosha mbi 65 vjeç)” dhe “Kujdesi shëndetësor mendor”. Një ndër qëllimet e shërbimit të kujdesit shëndetësor për të moshuarit, është identifikimi dhe ndjekja e problemeve të zakonshme mjekësore në të moshuarit, ku identifikohen si të tilla edhe sëmundjet mendore dhe probleme të shëndetit mendor (psikoza senile, deliri, depresioni). Nga ana tjetër, *shërbimi i kujdesit shëndetësor mendor*, synon që individët të kthehen në gjendjen e tyre të plotë funksionale, duke identifikuar dhe menaxhuar problemet e shëndetit mendor. Në kuadër të ofrimit të *shërbimit të kujdesit mendor*, një ndër rastet kur rekomandohet referimi i një pacienti është kur, pacienti është i moshuar, konfuz dhe paraqitja e historisë nga ai është e paqartë.

Komisioneri nuk mund të japë vlerësime në lidhje me rekomandimet e bëra nga Mjeku i Familjes Dr. B.M, për kryerjen e vizitave tek psikiatri, por referuar aktit të mësipërm, Komisioneri nuk konstaton veprime të cilat vijnë në kundërshtim me parashikimet VKM nr.101, datë 04.02.2015. Nga ana tjetër, mjeku B.M, nuk ka vendosur diagnoza që kanë të bëjnë me shëndetin mendor të ankuseses, por ka rekomanduar vizitë tek mjeku specialist psikiatër.

Ankuesja nuk shpjegon se, përse mosvenia në dispozicionin e saj të kartelës origjinale mjekësore e ka penguar atë për të marrë shërbimet e nevojshme mjekësore. Ajo nuk jep informacion në lidhje me asnjë situatë apo ngjarje konkrete, kur ajo është penguar në marrjen e rekomandimeve apo kryerjen e vizitave pranë specialistëve përkatës për këtë shkak. Ndërkohë që, prej datës 28.02.2023, ankuesja ka kaluar në sistem pranë Dr.N.Gj, mjek familje pranë Qendrës Shëndetësore Nr.5, Tiranë. Komisioneri nuk mund të shqyrtojë situata hipotetike apo abstrakte dhe të papërcaktuara, por për fakte dhe rrethana konkrete.

Pretendimet e ankuseses se, në kartelën e saj mjekësore janë bërë ndërhyrje dhe fallsifikime, janë pretendime për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 188 “*Falsifikimi i dokumenteve shëndetësore*”, të Kodit Penal, ku sanksionohet: “*Falsifikimi apo përdorimi i dokumenteve të falsifikuara shëndetësore dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Kur falsifikimi bëhet nga personi që ka për detyrë të lëshojë dokumentin, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet.*” dhe Komisioneri nuk ka kompetencë për shqyrtimin e tyre.

Bazuar në tërësinë e arsytimit të mësipërm si dhe në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se, ankuesja E.Q, nuk i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga ana e z. B.M, mjek familje pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë. Në mungesë të trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, Komisioneri arrin në përfundimin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese dhe shkelje të dispozitave të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar nga ana e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të ankueses E.Q nga z. B.M, Mjek Familje pranë Qendrës Shëndetësore Nr.9, Tiranë, për shkaqet e pretenduara prej saj “mosha” dhe “gjendja shëndetësore”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Shkaku: Mosha, gjendja shëndetësore
Fusha: Shëërbime
Lloji i vendimit: Mosdiskriminim